

QYTETI I SHKUPIT

Në përputhje me Programin për subvencionimin e qytetarëve për blerjen e kondicionerëve inverter me efikasitet të lartë për ngrohje, për vitin 2021 („Lajmëtari Zyrtar i Qytetit të Shkupit“ nr.05/21), Qyteti i Shkupit shpall

THIRRJE PUBLIKE

për subvencionimin e qytetarëve për blerjen e kondicionerëve inverter me efikasitet të lartë për ngrohje për vitin 2021

1. Përshkrimi i Thirrjes publike

- 1.1. Qyteti i Shkupit, me qëllim stimulimin e banorëve të qytetit të Shkupit (amvisëritë) për përdorimin e kondicionerëve inverter me efikasitet të lartë për ngrohje në shtëpitë e tyre, të cilat janë më ekonomike, më efikase nga ana energjetike dhe të pranueshme nga aspekti ekologjik, qytetarëve që kanë blerë kondicionerë inverter me efikasitet të lartë gjatë vitit 2021 do t'u kompensojë shpenzimet e bëra gjatë blerjes së pajisjes, jo më shumë se 62.000,00 denarë në vlerë neto për amvisëri. Tatimi personal do të jetë në barrë të Qytetit të Shkupit.
- 1.2. Thirrja publike do të zgjasë deri më 01 nëntor 2021 ose deri në shterimin e mjeteve financiare të parashikuara nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për këtë qëllim, në varësi prej asaj se cili kusht do të shfaqet i pari.
- 1.3. Në rast të shterimit të të gjitha mjeteve financiare të parashikuara me Buxhetin e Qytetit të Shkupit për këtë qëllim, Qyteti i Shkupit do ta informojë opinionin në ueb-faqen e tij se Thirrja publike është ndërprerë para skadimit të afatit për të cilin është shpallur.
- 1.4. Thirrja publike do të realizohet sipas radhës së aplikimit, përkatësisht sipas datës dhe kohës së aplikimit dhe pas dërgimit të vërtetimit për stufën e dorëzuar.

2. E drejta për pjesëmarrje në Thirrjen publike:

- 2.1 Të drejtë për pjesëmarrje në Thirrjen publike kanë banorët e qytetit të Shkupit (në komunat: Aerodrom, Gazi Babë, Kisella Vodë, Karposh, Çair, Shuto Orizare, Qendër, Gjorçe Petrov, Butel, Saraj) të cilët kanë blerë kondicionerë inverter me efikasitet të lartë për ngrohjen e shtëpisë së tyre në periudhën nga 01.01.2021 deri në përfundimin e Thirrjes publike dhe që do të depozitojnë kërkesë për kompensimin e shpenzimeve.
- 2.2 Në Thirrjen publike nuk kanë të drejtën e pjesëmarrjes banorët (amvisëritë) të cilët posedojnë objekte banimi që janë lidhura në ngrohjen qendrore të qytetit pa marrë parasysh nëse atë e shfrytëzojnë apo jo, ato që kanë mundësi teknike për lidhje në sistemin për ngrohje qendrore si dhe banorët (amvisëritë) të cilët posedojnë objekt banimi në fazën e ndërtimit dhe nuk jetojnë në të njëjtin.
- 2.3 Në Thirrjen publike kanë të drejtën e pjesëmarrjes dy ose më shumë amvisëri të cilët jetojnë sipas kartës së identitetit në të njëjtën adresë, vetëm me dëshmi të bashkëngjitur se bëhet fjalë për dy familje të ndara (fatura për matës të ndryshëm të energjisë elektrike).

3. Kushtet të cilat duhet t'i plotësojë aplikuesi:

- 3.1. Aplikuesi duhet t'i plotësojë kushtet e mëposhtme:
 - të ketë në vendbanim në territorin e qytetit të Shkupit (komunat: Aerodrom, Gazi Babë, Kisella Voda, Karposh, Çair, Shto Orizare, Qendër, Gjorçe Petrov, Butel, Saraj),
 - familja të mos ketë shfrytëzuar subvencione për ngrohje (stufë me pelet / inverter) të shtëpisë së tyre nga Qyteti i Shkupit,
 - të jetë përdorues i stufës me qymyr, dru, naftë ose mazut,
 - t'ia dorëzojë stufën ekzistuese me qymyr, dru, naftë ose mazut Qytetit të Shkupit ose shërbimeve të ndërmarrjeve publike të Qytetit të Shkupit. Aplikuesit të cilët kanë plotësuar

kushtet, do të njoftohen në mënyrë elektronike nga ana e komisionit për vendin dhe kohën e dorëzimit të stufës;

- pajisja të jetë blerë në vitin 2021 deri në përfundimin e Thirrjes publike, dhe e njëjta të jetë e paguar tërësisht dhe të jetë e instaluar në adresën e banimit të theksuar në kartën e identitetit të aplikuesit. Nëse pajisja është blerë me këste, e njëjta të jetë blerë në vitin 2021 dhe këstet të jenë paguar në tërësi deri në ditën e aplikimit.
- pajisja e blerë, detyrimisht të posedojë së paku karakteristikat e mëposhtme: të posedojë së paku SOR 3.5, të ngrohë në temperaturë të jashtme prej -15°C dhe të jetë së paku e klasës energjetik A+, për shpenzimin e energjisë elektrike për ngrohje;
- objekti i banimit të mos jetë në fazën e ndërtimit dhe aplikuesi të jetojë në të,
- të mos ketë qasje në ngrohjen qendrore në objektin banesor ku do të instalohet pajisja, pa marrë parasysh nëse e shfrytëzon të njëjtën apo jo, dhe
- të mos ketë mundësi teknike për kyçje në sistemin e ngrohjes qendrore.

3.2 Vetëm një person për familje mund të depozitojë kërkesë për marrjen e kompensimit, ku kërkesa **mund të përfshijë një ose më shumë pajisje**, por aplikuesi duhet t'i plotësojë kushtet e kësaj thirrjeje publike për të gjitha pajisjet, të dorëzojë aq stufa, sa ka blerë edhe pajisje dhe kompensimi i shpenzimeve të bëra gjatë blerjes së të gjitha pajisjeve të mos tejkalojë shumën prej 62.000,00 denarë në vlerë neto.

3.3 Më shumë familje që janë regjistruar në të njëjtën adresë detyrimisht të depozitojnë fatura nga matës të ndryshëm të energjisë elektrike si dëshmi se janë familje të ndara

3.4 Aplikuesit të cilët kanë vendbanim në objekte banesore në rajone ku ka ngrohje qendrore detyrimisht duhet të paraqesin vërtetim se nuk janë lidhur dhe nuk kanë mundësi teknike të lidhen me të njëjtën (vërtetim nga BEG – furnizim me energji ngrohëse, „Elem Energjetika“ ose Toplana „Shkup Veri“ – në varësi të rajonit ku banojnë)

4. Mënyra e aplikimit në Thirrjen publike

4.1. Për kompensimin e shpenzimeve dhe konfirmimin se kriteret për pjesëmarrje janë përmbushur, aplikuesi pranë Qytetit të Shkupit duhet të depozitojë në mënyrë elektronike:

- kërkesë të nënshkruar dhe skanuar për kompensim (Kërkesa mund të sigurohet prej faqes zyrtare të Qytetit të Shkupit: www.skopje.gov.mk);
- letërnjoftim i vlefshëm i skanuar në të dy anët, si dëshmi se është banor i qytetit të Shkupit (pasaporta nuk njihet);
- fotografi e stufës me dru, qymyr, naftë ose mazut, të cilën e shfrytëzon;
- deklaratën e skanuar e noterizuar me të cilën konfirmon se vullnetarisht dhe pa kompensim do ta/t'i dorëzojë stufën ekzistuese me qymyr, dru, naftë ose mazut të cilën e shfrytëzon, Qytetit të Shkupit ose shërbimeve të ndërmarrjeve publike të Qytetit të Shkupit dhe se nuk ka shfrytëzuar subvencione për ngrohje (stufë me pelet / inverter) në amvisërinë e tij nga Qyteti i Shkupit (ekzemplari i deklaratës do të shpallet në faqen zyrtare të Qytetit të Shkupit: www.skopje.gov.mk);
- vërtetim/e origjinal i skanuar dhe vërtetuar me nënshkrim dhe vulë nga shitësi, se kondicioneri inverter i blerë është me efikasitet të lartë, d.m.th. i plotëson karakteristikat minimale të mëposhtme: të posedojë së paku SOR 3.5, të ngrohë në temperaturë të jashtme prej -15°C dhe se i përket së paku klasës energjetike A+, për shpenzimin e energjisë

elektrike për ngrohje (ekzemplari i vërtetimit do të shpallet në faqen zyrtare të Qytetit të Shkupit: www.skopje.gov.mk);

- dëshmi origjinale e skanuar se blerja është realizuar gjatë vitit 2021, edhe atë vetëm me llogari fiskale të skanuar ose me faturë të bashkëngjitur me certifikatë nga një bankë afariste, si dëshmi për realizimin e pagesës në tërësi ose faturë me fletëpagesë të bashkëngjitur.
- llogari transaksioni e skanuar vetëm e aplikuesit (jo e autorizuar nga një person i tretë).
- Dokumente shtesë:
 - për familje të veçanta të cilat janë të në njëjtën adresë banimi – fatura të matësve të energjisë elektrike
 - për aplikuesit të cilët kanë vendbanim në objekte banesore në rajone ku ka ngrohje qendrore - vërtetim se nuk janë të lidhur në ngrohjen qendrore dhe nuk kanë mundësi teknike të lidhen me të njëjtën (vërtetim nga BEG – furnizim me energji ngrohëse, „Elem Energjetika“ ose Toplana „Shkup Veri“ – në varësi të rajonit ku banojnë)

4.2. Aplikuesi duhet aplikimin dhe dokumentacionin tjetër t'i bashkëngjisë të skanuara në platformën për aplikime on-line të shpallur në faqen e internetit të Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk ose direkt në link-un <https://aplikacii.skopjelaab.mk/inverteri/>.

4.3. Aplikimet e arritura me dokumentacionin përcjellës në platformën për aplikime on-line të shpallur në faqen zyrtare të Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk) do të evidentohen me orën e saktë të depozitimit (datë, orë dhe minuta), me qëllim përcaktimin e radhitjes sipas cilës do të shqyrtohen aplikimet.

4.4. Në rast të dokumentacionit të parregullt (të palexueshëm) dhe të pakompletuar, Komisioni rezervon të drejtën të kërkojë plotësim në mënyrë elektronike, të cilin aplikuesi duhet ta depozitojë në afatin më të shkurtër të mundshëm nga dita e njoftimit. Nëse nuk është kryer plotësimi, Komisioni refuzon aplikimin si të pakompletuar.

5. Mënyra e realizimit të Thirrjes publike

5.1. Kryetari i Qytetit të Shkupit formon Komisionin për zbatimin e Thirrjes publike, i cili do ta realizojë procedurën në tre faza:

- në fazën e parë, do t'i shqyrtojë dhe do të kryejë kontroll të hollësishëm të aplikimeve të arritura dhe dokumentacionin e bashkëngjitur, me qëllim që të përcaktojë nëse të njëjtat janë të rregullta dhe të kompletuara dhe nëse i plotësojnë kushtet nga pika 3 e kësaj Thirrjeje publike;
- në fazën e dytë, Komisioni aplikuesve të cilët plotësojnë kushtet do t'i njoftojë në mënyrë elektronike për vendin dhe kohën e dorëzimit të stufës/ve, dhe
- në fazën e tretë, dhe do të kryejë shqyrtimin e vërtetimeve për stufat e dorëzuara dhe do të vazhdojë procedurën për realizim përfundimtar.

5.2. Komisioni rezervon të drejtën e kontrollit në terren tek aplikuesit të cilët kanë depozituar dokumentacion të rregullt dhe të kompletuar, për të konfirmuar se kanë plotësuar kushtet e Thirrjes publike. Aplikuesi është i obliguar që t'i mundësojë qasje Komisionit deri te objekti i banimit dhe hapësira ku është instaluar kondicioneri i blerë inverter me efikasitet të lartë.

5.3. Për aplikimet e depozituara dhe të shqyrtuara nga pika 5, nënpika 5.1 alineja 1, do të mbahet listë elektronike me të dhënat vijuese:

- emri, mbiemri dhe adresa,
- data dhe ora e dorëzimit të aplikimit për Thirrjen publike, dhe

- vlera e kompensimit për aplikuesin.

5.4. Paguesa e mjeteve të lejuara do të kryhet në mënyrë sukcesive, sipas radhitjes së aplikimeve të depozituara, dhe vërtetimit të depozituar për dorëzimin e stufës, pas miratimit paraprak të aktvendimeve për miratimin e aplikimeve nga ana e Kryetarit të Qytetit të Shkupit, dhe

5.5. Pas përfundimit të të gjithë procedurës, aplikuesi duhet t'i mundësojë Komisionit qasje deri te objekti i banimit dhe hapësira në të cilën është instaluar pajisja edhe gjatë 2 viteve të ardhshme, pas përfundimit të Thirrjes publike.

6. Mënyra e realizimit të së drejtës së kompensimit

6.1. Kryetari i Qytetit të Shkupit në propozim të Komisionit sjell aktvendim për pranimin e aplikimit për aplikuesit, të cilët i kanë plotësuar kushtet e kësaj Thirrjeje publike, ndërsa në rast të mospranimit të aplikimit, me propozim të Komisionit, Kryetari i Qytetit të Shkupit lëshon njoftim me shkrim për mos pranimin e kërkesës.